



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike

**Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy for
Public Safety**



RAPORTI VJETOR I PUNËS AKSP - 2025



Vushtrri, Janar 2026

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
STRUKTURA ORGANIZATIVE.....	5
MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE OBJEKTIVAT	6
BORDI I AKSP-së.....	7
1. ARSIMI I LARTË.....	8
2. TRAJNIMET DHE PËRKRAHJA ARSIMORE	10
2.1. TRAJNIMET E MBAJTURA	10
2.2. SHËRBIMET STUDENTORE.....	10
2.3. BIBLIOTEKA	11
2.4. PËRKRAHJA GJUHËSORE	11
2.5. KURIKULAT DHE TESTIMET.....	11
2.6. SHËRBIMET E MULTIMEDIAS DHE FOTOKOPJËS	11
3. LEGJISLACIONI DHE PLANIFIKIMI	12
3.1. LEGJISLACIONI.....	12
3.2. PLANIFIKIMI STRATEGJIK	13
4. FINANCA DHE SHËRBIME TË PËRGJITHSHME	14
4.1. BURIMET NJERZORE.....	14
4.2. SHËRBIMET E PËRBASHKËTA	15
4.3. FINANCAT	16
4.4. TEKNOLOGJIA INFORMATIVE	16
5. CILËSIA.....	17
5.1. AVANCIMI I SISTEMEVE DHE POLITIKAVE TË MENAXHIMIT TË CILËSISË SIPAS STANDARDEVE BASHKOHORE.....	17
5.2. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË SIGURIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË (AKK, AKA, IADLEST).....	18
5.3. AKTIVITETET DHE GJENDJA AKTUALE	19
6. BASHKËPUNIMI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR	20
6.1. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDORE.....	20
6.2. BASHKËPUNIMI ME PARTNER NDËRKOMBËTAR BRENDË VENDIT	20
6.3. BASHKËPUNIMI ME ASOCIACIONE DHE RRJETE NDËRKOMBËTARE.....	21
6.4. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE TË NDRYSHME JASHTË VENDIT	22
6.5. VIZITAT ZYRTARE DHE NGJARJET ONLINE TË REALIZUARA	23
7. KOMUNIKIMI DHE MEDIA.....	27
8. AUDITIMI.....	28
9. PROKURIMI.....	29

Në emër të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike/ AKSP kemi kënaqësinë që përmes këtij raporti vjetor të pasqyrojmë veprimtarinë dhe aktivitetet e AKSP-së konformë obligimeve dhe detyrave të saja ligjore.

Bazuar në Ligjin nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (tutje AKSP) është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme e cila është përgjegjëse për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike për të gjitha Institucionet e Sigurisë Publike duke mos u kufizuar vetëm në: Policia e Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Dogana e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave dhe Inspektorati Policor i Kosovës.

AKSP-ja të gjitha aktivitetet dhe veprimet që i ndërmerr janë të koordinuara përmes prioritetëve të MPB-së, Planit Vjetor të Punës së AKSP-së për vitin 2025 dhe Strategjisë Zhvillimore dhe Planit të Veprimit të AKSP 2023 – 2026.

Përmes këtij raportit pasqyrohet veprimtaria e AKSP-së konformë obligimeve dhe detyrave të saja ligjore duke u mbështetur në punën efektive e cila është drejtuar nga vizioni dhe misioni i saj i udhëhequr nga parimet: profesionale, transparente, etike, efektive dhe të përgjegjshme.

Të arriturat e periudhës raportuese janë si rezultat i punës së stafit të AKSP-së të cilët kanë dhënë kontributin e tyre qoftë individual apo grupor në kryerjen me përgjegjësi dhe profesionalizëm të plotë të detyrave të punës dhe njëkohësisht duke falënderuar për punën dhe bashkëpunimin e Institucioneve të Sigurisë Publike dhe partnerëve Ndërkombëtar të cilët kanë mbështetur AKSP-në në arritjen e sukseseve

Duke pasur një mision të qartë, AKSP është e përkushtuar në arsimimin dhe trajnimin e zbatuesve të ligjit në mënyrë që të pajisë dhe avancojë njohuritë dhe shkathtësitë e duhura për të gjithë pjesëtarët e Institucioneve të Sigurisë Publike që u shërbejnë qytetarëve të Republikës së Kosovës për të qenë të sigurt në ambientet ku jetojnë dhe veprojnë.

Raporti ka për qëllim prezantimin e informatave dhe treguesve në implementimin e objektivave të saja për periudhën raportuese janar – shtator 2025.

Si të arritura kryesore në fusha të ndryshme brenda kësaj periudhe mund ti veçojmë:

- ✓ Realizimi i 76 trajnimeve me gjithsej 2039 zyrtar të Institucioneve të Sigurisë Publike
- ✓ Realizimi me sukses i pjesës teorike në AKSP të trajnimit profesional „ **Polic i Ri**” për gjeneratën 61 dhe 62 të Policisë së Kosovës me gjithsej 741 kadet.
- ✓ Realizimi me sukses në AKSP i Trajnimit Profesional „ **Zyrtar Korrektues**” gjenerata e 45-të e Shërbimit Korrektues të Kosovës me gjithsej 111 kadetë.
- ✓ Realizimi me sukses në AKSP i trajnimit profesional „ **Zyrtar Doganor**” gjenerata 01/2025 dhe 02/2025 të Doganave të Kosovës me gjithsej 108 kadetë.
- ✓ Aplikimi i AKSP-së për Ri-akreditim institucional dhe programor në Agjencinë e Kosovës për Akreditim/ AKA
- ✓ Hartimi i 10 akteve normative të brendshme që lidhen me proceset akredituese
- ✓ Nënshkrimi i marrëveshjes bashkëpunimit ndërinstytucional mes AKSP dhe Akademisë Policore të Malit të Zi.
- ✓ Nënshkrimi i marrëveshjes bashkëpunimit ndërinstytucional mes AKSP dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës /KGJK
- ✓ Zhvillimi i aktivitetit „ Fuqizimi i rolit të rinisë në paqe dhe siguri” në AKSP
- ✓ Pjesëmarrja e AKSP-së në panairin e edukimit, Karrierës dhe Punës.
- ✓ Pranimi i vlerësimit ndërkombëtarë të akreditimit të AKSP-së me „ Çmimi i Ekselencës” nga IADLEST – SHBA
- ✓ Organizimi i tryezës shkencore “Inteligjenca artificiale në sigurinë publike dhe drejtësinë penale: Bashkëveprimi ndërinstytucional për siguri dhe etikë”
- ✓ Diplomimi i 5 studentëve të FSP-së zyrtar të sigurisë publike
- ✓ Hartimi i 8 raporteve dhe 4 planeve
- ✓ Organizimi i Ditës Informuese për Komunitete për 65 të rinj nga AKSP në bashkëpunim me Zyrën për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit
- ✓ Pranimi i 15 vizitave me 1066 vizitorë/nxënës nga institucione shkollore dhe parashkollore, duke ofruar shërbime informuese gjatë qëndrimit të tyre në AKSP.
- ✓ Pranimi i **dhjetëra vizata** zyrtare duke përfshirë përfaqësues nga misione diplomatike, organizata ndërkombëtare, si dhe institucione partnere vendore dhe ndërkombëtare



STRUKTURA ORGANIZATIVE




AKSP-ja ka të rregulluar sistemin e brendshëm të organizimit sipas Rregullore (QRK) Nr. 05/2014 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike dhe funksionon e organizuar në njësi si; Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm, Fakulteti i Sigurisë Publike, Departamente dhe Divizione. Tashmë AKSP është në fazën e ri-organizimit të strukturës së brendshme organizative e cila pritet të miratohet.

Bazuar ne Ligjin Nr.04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike personeli i AKSP-se ndahet ne: personel menaxhues; personel trajnues dhe mësimdhënës dhe personel mbështetës;

Numri i vendeve të punës me buxhet e përcaktuar është 156 ndërsa numri aktual i të punësuarve është 127.

Struktura organizative



MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE OBJEKTIVAT

Misioni institucional është i përcaktuar në Ligjin e AKSP-së ndërsa vizioni, vlerat dhe objektivat e AKSP-së janë të përcaktuara në dokumentin zhvillimor institucional të miratuar „Strategjia Zhvillimore dhe Plani i Veprimit të AKSP-së 2023-2026”

Misioni - të ofroj trajnim, arsimim dhe hulumtim me cilësi të lartë në fushën e sigurisë publike për të ndihmuar në ofrimin e ambientit të sigurtë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Vizioni - Akademia përmes ofrimit të trajnimeve dhe arsimimit me cilësi dhe standarde të ekselencës do të jetë faktor kyç në ngritjen e kapaciteteve të zbatuesve të ligjit konformë ndryshimeve dhe sfidave me të cilat përballën

Vlerat - AKSP-ja ka përcaktuar këto vlera themelore: **ndershmëria, transparenca, përgjegjshmëria, etika profesionale dhe diversiteti.**

Objektivat strategjike të AKSP-së janë:



Ngritja e kapaciteteve profesionale të institucioneve të sigurisë publike përmes ofrimit të programeve trajnuese të standardizuar



Avancimi i arsimit të lartë në siguri publike



Zhvillimi i profilit hulumtues në shërbim të sigurisë publike



Avancimi i sistemeve të menaxhimit të cilësisë sipas standardeve bashkëkohore në zbatimin e politikave të sigurimit të cilësisë dhe procesit të përmirësimit



Përmirësimi i kornizës ligjore dhe menaxhim efikas i burimeve njerëzore, infrastrukturore dhe proceseve të punës në përputhje me praktikën dhe standardet më të mira



Fuqizimi i bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar si dhe rritja e kredibilitetit të AKSP

Akademia e Kosovës për Siguri Publike është institucion përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike.

Me qëllim të arritjes së objektivave të Akademisë dhe akordimit të politikave që kanë të bëjnë me trajnimet në fushën e sigurisë publike për Institucionet e Sigurisë Publike është paraparë edhe themelimi i Bordit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike me qëllim të vendosjes së minimumit bazë të standardeve profesionale, politikave që kanë të bëjnë me trajnimet në fushën e sigurisë publike, edukimin e specializuar dhe të avancuar të zyrtarëve të Institucioneve për Siguri Publike.

Bordi është i organizuar në bazë të Rregullores nr. 06/2013 për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, ku me këtë rregullore përcaktohet përbërja, përgjegjësitë si dhe rregullat e punës.



Bordi përbëhet nga 8 anëtarët si vijon:

- Kryeprokurori i Shtetit;
- Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës;
- Drejtori i Doganave të Kosovës;
- Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues të Kosovës;
- Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave;
- Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës, si dhe
- Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike – anëtar pa të drejtë vote.

Gjatë periudhës raportues Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (AKSP) mbajti takimin e 44-të të radhës i cili takim u përqendrua në diskutimin e standardeve profesionale për institucionet e sigurisë, si dhe në shqyrtimin e projekt-planit vjetor të trajnimeve AKSP 2026, në fushën e sigurisë publike.

Anëtarët e Bordit u informuan për aktivitetet dhe veprimet e ndërmarra gjatë vitit 2025, duke theksuar se Akademia mbetet e përkushtuar për të bashkëpunuar ngushtë me të gjitha institucionet e sigurisë publike në realizimin e programeve trajnuese dhe arsimore të planifikuara, po ashtu u theksua se gatishmëria e Akademisë për të ofruar trajnime shtesë, në varësi të nevojave specifike të institucioneve të sigurisë.

1. ARSIMI I LARTË

Fakulteti për Siguri Publike gjatë kësaj periudhe ka pasur angazhime të shumta në funksion të realizimi të misionit të vet të përcaktuar ligjërisht. Fokusi kryesor i punës ka qenë përmbushja e angazhimeve akademike të mësimdhënies, hulumtimit dhe përcjellës së punës me student, dhe implementimi i Intershipit (periudha praktike) si dhe puna rreth procesit të Ri-akreditimit programor të Fakultetit.

Organizimi i mësimdhënies, provimeve dhe vlerësimeve të studentëve – Gjatë kësaj periudhës raportuese janë organizuar afatet e rregullta të provimeve sipas planifikimit për mbajtjen e tyre.

Qëndrueshmëria e arsimit të lartë në FSP – AKSP - Fillim vitin 2025 FSP ka hartuar dokumenti strategjik me titull “Dokument për Bashkërendimin e Politikave për Qëndrueshmërinë e Arsimit të Lartë në Fushën e Sigurisë Publike”, i cili ka shërbyer si bazë konceptuale dhe operative për harmonizimin e politikave të arsimit të lartë me institucionet relevante.

Gjatë këtij viti është realizuar analiza e qëndrueshmërisë së numrit të studentëve të programeve studimore. Si rezultat është hartuar Strategjia për qëndrueshmërinë e numrit të studentëve në Fakultetin e Sigurisë Publike, si dhe një plan dinamik veprimi për zbatimin e saj.

Vlerësimi, analizimi dhe rishikimi i programit studimor - Drejtori i Përgjithshëm i AKSP me vendimin nr. 85 datë 19.06.2025, ka themeluar grupi punues për vlerësimin dhe rishikimin e Programit Bachelor në “Siguri Publike”. Vlerësimi, analizimi dhe rishikimi i programit studimor BA në siguri Publike ka përfunduar dhe i njëjti është miratuar nga këshilli i FSP-së me 04.09.2025 dhe e njëjta është proceduar në Agjencinë e Kosovës për Akreditim.

Hartimi i dokumenteve planifikuese – Po ashtu janë hartuar edhe shumë dokumente , udhëzues e manuale që lidhën me punën e Fakultetit si: Udhëzuesi për Hartimin edhe Rishikimin e Syllabuseve, Manuali për Hartimin dhe Rishikimin të Kurikulës, Doracaku i Intershipit, Manuali i studentëve etj.

Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim (IHZH) – ka informuar rregullisht stafit rreth ftesave për aplikim në grante, publikime, konferenca, seminare dhe punëtori me interes, Personeli akademik me marrëdhënie të rregullt pune është në vazhdimësi i angazhuar në hulumtime dhe publikime shkencore në revista të indeksuara sipas standardeve të AKA në fushat e interesit të tyre. Po ashtu është hartuar dhe miratuar edhe Plani Strategjik për

Hulumtimet Shkencore 2026–2028, ku janë përcaktuar fushat prioritare të hulumtimit në fushën e sigurisë publike.

AKSP ka pranuar edhe 20 tituj librash shkencorë në fushën e sigurisë publike, duke kontribuar në pasurimin e literaturës akademike

Organizimi i tryezës shkencore – Me 20 qershor 2025 AKSP- FSP organizuan tryezën shkencore **“Inteligjenca artificiale në sigurinë publike dhe drejtësinë penale: Bashkëveprimi ndërinstytucional për siguri dhe etikë”**, ku u diskutua për përparësitë dhe sfidat institucionale të aplikimit të Inteligjencës Artificiale/ AI në sistemin e sigurisë publike dhe sistemin e drejtësisë, me pjesëmarrës nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Institucionet e Sigurisë Publike që veprojnë në AKSP (PK, SHKK, DK), përfaqësues nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, Programi i ICITAP në Kosovë, studentë të FSP-së dhe niveli i ndryshëm i stafit të AKSP-së.

Themelimi i Këshillit të Etikës - Më 30.09.2025 në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike u mbajt mbledhja e parë e Këshillit të Etikës, i cili ka mandatë promovimin e integritetit akademik, respektimin e normave etike dhe adresimin e çështjeve që lidhen me etikën profesionale dhe akademike

Fuqizimi i rolit të studentëve – Në janar 2025 është zgjedhur Këshilli Studentor me strukturat e tij, ndërsa përfaqësuesi i studentëve është përfshirë në grupin punues për rishikimin e programit studimor. Po ashtu me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm është themeluar edhe Rrjeti Alumni i Fakultetit të Sigurisë Publike.

Menaxhimi i procesit të studentëve të padiplomuar - Fakulteti ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për rregullsinë dokumentare dhe për menaxhimin institucional të proceseve të diplomimeve. Është trajtuar si prioritet institucional çështja e diplomimeve të mbetura të studentëve, me theks të veçantë tek gjeneratat e regjistrimit 2014/2015 – 2020/2021. Këshilli ka miratuar vendimin për themelimin e Komisionit për analizimin e situatës së studentëve të pa-diplomuar

Mbrojtja e Temës së Diplomës - Gjatë periudhës raportuese në Fakultetin për Siguri Publike pas përfundimit të gjitha procedurave dhe prezantimit të punimeve kanë diplomuar gjithsej 27 studentë / zyrtarë të sigurisë publike.

2. TRAJNIMET DHE PËRKRAHJA ARSIMORE



Në lidhje me implementimin e trajnimeve AKSP ka pasur koordinim dhe komunikim me akterët përkatës të ISP-ve ku pas konsultimeve me ISP, partnerët ndërkombëtarë dhe Bordit të AKSP-së, Drejtori i Përgjithshëm me vendimin nr. 259 të datës 09.12.2024 ka miratuar Planin Vjetor të Trajnimeve të AKSP-së për vitin 2025.

Gjatë periudhës raportuese në bashkëpunim me ekspertet e fushave përkatëse të Agjencioneve është bërë zhvillimi i trajnimeve të reja sipas tabelës vijuese:

NR.	TRAJNIME TË REJA TË ZHVILLUARA
1	Trajnimi për Menaxhimin e zemërimit
2	Trajnimi për Zyrtarët e Sigurimit
3	Trajnimi Luftimi i krimit mjedisor
4	Kodi i Ri Doganor
5	Siguria dinamike

2.1. TRAJNIMET E MBAJTURA

AKSP në kuadër të përgjegjësiive për ofrimin e trajnimeve për institucionet e sigurisë publike si dhe planit vjetor për trajnime për vitin 2025 në bashkëpunim të ngushtë me ISP-të dhe partnerët ndërkombëtar (ICITAP, OSBE) gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor ka organizuar gjithsejtë **108 trajnime me 2569 vijues të trajnimeve**.

Në vijim janë të pasqyruar numri i trajnimeve dhe numri i vijuesve sipas agjencioneve të sigurisë publike si dhe organizatave / partnerëve ndërkombëtar:

NR.	AGJENCIONET/ORGANIZATAT	NR. TRAJNIMEVE	NR. VIJUESVE
1	Policia e Kosovës	66	1698
2	Agjencia për Menaxhim të Emergjencave	9	149
3	Shërbimi korrektues i Kosovës	7	165
4	Dogana e Kosovës	7	176
5	OSBE	4	90
6	Agjencia Suedeze e Kontingjencave Civile	1	13
7	Trajnimet e Përbashkëta	14	278
Total	Numri i trajnimeve dhe vijuesve	108	2569

2.2. SHËRBIMET STUDENTORE

Gjatë kësaj periudhe janë bashkërenduar punët dhe shërbimet e administratës me pjesën tjetër akademike të arsimit të lartë dhe trajnimet lidhur me menaxhimin e hapësirave mësimore, oraret e ligjëratave dhe trajnimeve, rezultatet e provimeve dhe testeve,

njoftimet mbi aktivitete të tjera që ndërlidhen me AKSP-në dhe njërive tjera, futja në sisteme dhe data baza të dhënave të vijuesve etj.

2.3. BIBLIOTEKA

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të zbatuesve të ligjit, është punuar në krijimin e kushteve të përshtatshme të bibliotekës për nevojat e vijuesve të AKSP-së ku në këtë aspekt gjatë periudhës raportuese janë dhënë 112 libra për lexim për vijuesit e AKSP-së, në programin e bibliotekës deri më tani kemi rreth 567 anëtarë të regjistruar në bibliotekën e AKSP.

2.4. PËRKRAHJA GJUHËSORE

Përveç gjuhës shqipe, AKSP ofron trajnime edhe në gjuhën serbe. Po ashtu, me rastin e ofrimit të trajnimeve nga organizatat dhe institucionet e huaja në AKSP ofrohet përkthim në gjuhën angleze. Si rezultat i përgjigjes ndaj këtyre nevojave janë ofruar këto shërbime: **Shërbimet e Përkthimit në formën e shkruar** – janë proceduar **3328** kërkesa, ku prej tyre **1278** faqe nga gjuha shqipe në atë angleze dhe anasjelltas si dhe **2050** faqe nga gjuha shqipe në atë serbe dhe anasjelltas.

Shërbimet e Përkthimit Verbal – Janë mbuluar me përkthim verbal mesatarisht 2 trajnime/aktivitete për javë me përkthim verbal.

Shërbimet e Lekturës dhe e Korrekturës – Në bazë të kërkesave për lekturë dhe korrekturë të materialit janë lekturuar gjithsejtë 670 faqe.

2.5. KURIKULAT DHE TESTIMET

Në lidhje me Kurrikulat janë formatizuar gjithsej 5 trajnime ndërsa janë harmonizuar **580** mësimet/doracak. Sa i përket mbajtjes së testimeve për trajnimet që i nënshtrohen testit gjatë periudhës raportuese janë realizuar këto aktivitete si në vijim:

TRAJNIMET QË I JANË NËNSHTRUAR TESTIMIT			
Numri i trajnimeve	Nr. testuarve	Ri-testim	Dështim
41	7258	428	61

2.6. SHËRBIMET E MULTIMEDIAS DHE FOTOKOPJËS

Gjatë periudhës së raportimit janë realizuar këto aktivitete të paraqitura si në vijim:

- Materiali i printuar dhe fotokopjuar **1049637** fletë
- Printimi me ngjyra 1555 Certifikata për kurse/trajnime (Letër A4) materialeve të ndryshme 8166 faqe
- Fotografimi, publikimi dhe arkivimi fotove për të gjitha aktivitetet në AKSP

3.1. LEGJISLACIONI



DÇL gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2025, ka përfunduar këto aktivitete në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi si dhe aktiviteteve të parapara në kuadër të planit vjetor të punës si në vijim :

- 111 draft vendime që kanë rregulluar dhe përcaktuar fusha dhe procese të ndryshme brenda institucionit;
- Hartimi i 10 akteve normative të brendshme që lidhen me proceset akredituese si:
 - Rregullore Nr. 01/2025 për procedurat dhe kriteret e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm në Arsimin e Lartë në AKSP
 - Rregullore Nr. 02/2025 për organizimin dhe funksionimin e Rrjetit të Alumni të AKSP-së
 - Rregullore (AKSP) Nr. 03/2025 për etikë dhe integritet në hulumtimin shkencor,
 - Rregullore Nr. 04/2025 për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelin Akademik të AKSP-së
 - Rregullore Nr.05/2025 për Ombudspersonin e studentëve të Arsimit të Lartë të AKSP-së,
 - Rregullore Nr.06/2025 për parandalimin dhe mbrojtjen nga ngacmimi dhe ngacmimi Seksual në AKSP
 - Rregullore Nr.07/2025 për të drejtat e autorit dhe pronësinë intelektuale në AKSP
 - Rregullore Nr.08/2025 për parandalimin dhe procedurën e kontrollit të plagjiaturës,
 - Rregullore Nr.09/2025 për veprimtarinë hulumtuese shkencore në AKSP
 - Rregullore Nr.10/2025 për vlerësimin e performancës së personelit akademik
- Pjesëmarrje në 15 komisioneve të ndryshme duke përfshirë (disiplinore, etikës dhe të ankesave)
- Procedimi i lëndëve gjyqësore tek MPB / Avokatura shtetërore gjithsej 109 lëndë
- Këshilla ligjore dhe konsultime
- 10 Shkresa të ndryshme për nevojat e njësive.
- Pjesëmarrja në 24 Grupe Punuese për hartimin e dokumenteve të ndryshme
- 8 njoftimet e njësive organizative në lidhje me aktet e reja normative (ndryshime ligjore) që lidhën me fushëveprimin e AKSP-së.

3.2. PLANIFIKIMI STRATEGJIK



Në aspektin e planifikimit strategjik janë hartuar raporte dhe plane vjetore për AKSP-në si dhe është ofruar mbështetje në lidhje me përcaktimin e objektivave dhe prioritetëve të Institucionit.

DPS ka zhvilluar takime dhe diskutime në lidhje me zbatimin e aktiviteteve nga dokumentet planifikuese si : Plani vjetor i punës 2025, Plani vjetor i Performancës 2025, zbatimi i aktiviteteve nga strategjia zhvillimore AKSP-së 2023 – 2026.

Hartimi i raporteve dhe Planeve - Konformë obligimeve dhe kërkesave të pranuar nga njësit dhe institucionet tjera gjatë periudhës raportuese janë hartuar mbi **22 raporte dhe 12 Plane** të ndryshme për prezantimin e të dhënave dhe aktiviteteve të AKSP-së si vijon:

- 12 Raporte mujore të AKSP-së për MPB
- 12 Plane mujore të AKSP-së për MPB;
- 3 Raporte periodike të punës së AKSP-së (TM1,TM2 ,TM3 – 2025)
- 3 Raporte të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Planit Vjetor të Punës
- Hartimi i Raportit dhe dëshmisë për Parimin 10 – Efektivitetin e Kontrollit të Brendshëm dhe Menaxhimit të Rrezikut
- Plotësimi i pyetësorit për Vlerësimin afatmesëm të SKMDHFDHNG 2022–2026
- Raport vjetor i punës për vitin 2024;
- Plotësimi i raportit - pyetësorit të kontrollit të menaxhimit financiar të AKSP sipas kriterëve dhe afateve të NJQH-MFPT;
- Hartimi i Raportit të performancës së AKSP-së për vitin 2024.
- Hartimi i Planit të performancës së AKSP-së për vitin 2026 (i miratuar nga MPB)
- Hartimi raportit 6 mujor (janar-qershor 2025)të monitorimit dhe zbatimit të Planit të Integritetit të AKSP-së
- Hartimi i Raportit Vjetor 2024 të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Strategjisë Zhvillimore dhe Planit të Veprimit AKSP 2023-2026.

DPSÇL është angazhuar në të gjitha proceset e Akreditimit vendore dhe ndërkombëtarë të AKSP-së si dhe në proceset tjera që zhvillohen në AKSP.

4.1. BURIMET NJERZORE

Koordinimi dhe Planifikimi i BNJ - Me qëllim të koordinimit për planifikimin e burimeve njerëzore, janë organizuar takime të përbashkëta me udhëheqësit e njësive organizative të Akademisë.

Gjatë periudhës raportuese DBNJ ka arritur ti përmbush detyrat si në vijim:

- Njoftimi, dërgimi dhe Përpilimi i listës për zyrtarët e lartë dhe dërgimi tek Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.
- Dërgimi i njoftimit për Deklarimin e Dhuratave për vitin 2024.
- Raportimi i rasteve të Konfliktit të Interesit për vitin 2024.
- Dërgimi i planit vjetorë për vitin 2025 në MAPL
- Përfundimi i vlerësimeve të vitit 2024 për Stafin e shërbyesve Civil në AKSP.
- Përgatitja e Planit Vjetor të trajnimeve të nëpunësve civil 2025.
- Përgatitja e Raportit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për vitin 2022/2023 dhe 2024 kërkuar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, si dhe për nëpunësit e Shërbimit Civil / MPB.

Rekrutimi – Konkurse

- Rekrutimi – në pozitën e vendit të punës Mjek i Praktikës së Përgjithshme në AKSP.
- Shpallja e Konkursit Zyrtarë i Lartë për Informim me datën 19.02.2025 (Rekrutim).
- Shpallja e Konkursit Teknik – Elektricitist me datën 11.03.2025 (Rekrutim).
- Shpallja e Konkursit - Udhëheqës i Divizionit të Sigurimit dhe Hapësirave (anuluar).
- Shpallja e Konkursit për zgjedhjen e personelit akademik me marrëdhënie të rregullt të punës në FSP/ AKSP datës 20.06.2025 (Rekrutim).

Akt Emërimet - Me qëllim të adaptimit të ndryshimeve ligjore rreth ndryshimit të akt emërimeve të pozitave udhëheqëse, AKSP-ja ka ndryshuar 17 akte emërimi që më parë ishin me mandat të përhershëm duke i kthyer tani në emërim me mandat në afat 4 vjeçar.

Dorëheqje

- Me vendimin nr.176 të protokollit të datës **07.01.2025** miratohet dorëheqja nga detyrapozita e punës Administrator i Bazave të të Dhënave dhe Sistemeve në IT.
- Me vendimin nr.123 të protokollit të datës **04.03.2025** i miratohet dorëheqja nga detyra Mjek i Praktikës së Përgjithshme në AKSP.
- Me vendimin nr. 126 të protokollit të datës **10.03.2025** i miratohet dorëheqja nga detyrapozita Zyrtare e përkthimeve në AKSP.
- Me Vendimin nr. 127 të protokollit të datës **10.03.2025** i miratohet dorëheqja nga detyrapozita Zyrtare e përkthimeve në AKSP.

- Me vendimin nr. 128 të protokollit të datës **10.03.2025** i miratohet dorëheqja nga detyrëpozita Zyrtare e përkthimeve në AKSP.

Transferim i brendshëm - Janë realizuar 11 transfere të brendshme, disa prej të cilave janë të përkohshme me kohëzgjatje 1 vjeçare , në mbështetje të zhvillimit dhe akreditimit institucional.

Transferim i jashtëm - Marrëveshje për Transferim të Përkohshëm i nëpunësit civil nga pozita aktuale Udhëheqës i Divizionit për Çështje Ligjore në AKSP, në pozitën Udhëheqës i Divizionit për hartimin dhe harmonizimin e Legjislacionit në MPB, 23.09.2025 deri më 22.03.2026

Ndërprerja e marrëdhënies së punës – për shkak të vdekjes së punësuarit

- Zyrtare e Lartë i ndërpritet marrëdhënia e rregullt e punës nga data 03.11.2025
- Teknik -Elektricit i ndërpritet marrëdhënia e rregullt e punës nga data 30.11.2025

Pensionim- Udhëheqës i Divizionit të Trajnimeve i përfundon marrëdhënia e punës datë 30.10.2025, arrin moshën e pensionimit.

Trajnimi i Stafit të Akademisë

DBNJ në bashkëpunim me udhëheqësit e njësive ka identifikuar nevojat për trajnimin e personelit dhe ka përgatitur Planin e Trajnimeve për vitin 2025. Plani i Trajnimeve për stafin e AKSP përveç IKAP implementohet edhe në bashkëpunim me organizata tjera. Gjatë periudhës raportuese ka vijuar trajnime **147 nëpunës civil**.

4.2. SHËRBIMET E PËRBASHKËTA

Po ashtu janë përkrahur të gjitha njësitë me shërbime dhe furnizime të nevojshme si:

- Akomodimin në baza ditore 6,100 persona.
- Pjesëmarrës në trajnim ditor 8,550 persona.
- Kujdes shëndetësorë pranë AKSP-së kanë kërkuar gjithsejtë **1421** persona
- Shërbimet e transportit, pastrimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave të AKSP
- Arkivimi i Diplomave, Formave dhe Testeve.
- Përgatitja e objekteve për trajnime dhe për aktivitete të ndryshme.
- Furnizim me material shpenzues për zyre etj.
- Ofrimi i shërbimeve të sigurimit të hapësirave të AKSP-së për të gjitha aktivitetet që mbahen dhe organizohen në AKSP.

4.3. FINANCAT

Të dhënat statistikore janë të marruara nga Raportet e gjeneruara nga SIMFK si dhe raportet e brendshme financiare.

Tabela e buxhetit, alokimeve si dhe shpenzimeve buxhetore 01.01 – 31.12.2025 (Janar / Dhjetor 2025)								
Kategoritë ekonomike	Buxheti fillestar	Buxheti përfundimtar	Alokuar	Zotimet	Shpenzuara	Mjete të lira	Zotime %	Shpenzim %
Paga & Mëditje	1,269,731.00	1,140,847.00	1,140,847.00	0.00	1,140,847.00	0.00	0.00	100.00
Mallra Shërbime	1,614,221.00	1,569,650.68	1,569,650.68	95,895.15	1,411,567.79	62,187.74	6.11	89.93
Shpen. Komunali	144,030.00	130,701.00	130,701.00	11,842.57	118,857.61	0.82	9.06	90.94
Shpen. Kapitale	817,285.00	817,285.00	817,285.00	285,983.00	531,302.00	0.00	34.99	65.01
Total	3,845,267.00	3,658,483.68	3,658,483.68	393,720.72	3,202,574.40	62,188.56	10.76	87.54

4.4. TEKNOLOGJIA INFORMATIVE

Në fushën e teknologjisë informative ndër të tjera janë kryer këto aktivitete:

- Zhvillimi dhe implementimi i rregullave dhe procedurave për procedimin e të dhënave elektronike, funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të TI-së;
- Administrimi, konfigurimi, menaxhimi dhe monitorimi i Sistemit të Serverëve
- Administrimi i sistemit të video vëzhgimit (Sistemit të vëzhgimit me IP Kamera).
- Administrimi dhe monitorimi i sigurisë së rrjetit në baza ditore nga ndërhyrjet e mundshme (jashtme dhe brendshme)
- Mirëmbajtja e WEB faqes AKSP-së dhe Administrimi i Syslog Serverit.
- Monitorimi në baza ditore i punës së Web Faqes së AKSP-së
- Mbikëqyrja dhe menaxhimi i madhësisë së bazave të dhënave si dhe bërja backup (kopje rezervë) të bazave të dhënave.
- Administrimi i sistemit të Serverëve në platformën Linux (Sistemi i telefonisë fikse VOIP, sistemi i tarifimit të telefonisë fikse, sistemi Moodle, softueri për menaxhim të Bibliotekës, etj.)
- Administrimi i rrjetave LAN dhe Wireless në Kampusin e AKSP-së.
- Përkrahje teknike me pajisje për përkthim simultant:

5.1. AVANCIMI I SISTEMEVE DHE POLITIKAVE TË MENAXHIMIT TË CILËSISË SIPAS STANDARDEVE BASHKOHORE

Avancimi i sistemeve vlerësuese sipas sistemit Kirk-Patrick për programet trajnuese

- Me date 19.03.2025 u mbajt takimi i parë i Komisionit për Sigurimin e Cilësisë, ku pas shqyrtimit të dokumenteve të bashkangjitura nga fusha e sigurimit të cilësisë, u aprovua dokumenti Politikat e implementimit të sistemit Kirkpatrick, i cili në vete ka edhe planin dinamik të veprimit. Sistemi Kirkpatrick ka filluar të implementohet qysh nga vitit 2024 e tutje në kuadër të pyetësorëve vlerësues, kurse nga data 19.03.2025 mbështetet edhe me dokumentin zyrtar të aprovuar nga Komisioni për Sigurimin e Cilësisë;

Rishikimi i politikave të sigurimit të cilësisë sipas standardeve bashkëkohore

- Në kuadër të rishikimit të politikave për Sigurimin e Cilësisë, me date 19.03.2025 Komisioni për Sigurimin e Cilësisë aprovoj dokumentin e Standardeve të brendshme të Sigurimit të Cilësisë në kuadër të AKSP, të cilat i hapin rrugën rishikimit të doracakut të cilësisë;
- Komisioni i Cilësisë në takimin e fundit ka shqyrtuar politikat e sigurimit të cilësisë duke hapur rrugën për draftimin e rregullores për sigurimin e cilësisë, e cila u shqyrtua në takimin e datës 11.11.2025 ku nga KSC u vlerësua që fillimisht të hartohet Rregullorja pastaj të shtrihen plotësim/ndryshimi në dokumentet tjera të cilësisë,

Zhvillimi dhe zbatimi i politikave përmirësuese

- Në kuadër të raporteve individuale të trajnimeve të vlerësuara janë adresuar rekomandimet për fushat gjegjëse për përmirësim. Po ashtu plani i përmirësimit për vitin 2025 është adresuar për publikim në web-faqe;
- Planet e veprimit nga fusha e proceseve akredituese janë hartuar dhe adresuar tek aktet relevant duke përfshirë fushën e arsimit të lartë, si dhe planin përmirësues të procesit akreditues nga IADLEST.
- Procesi i shqyrtimit të planeve dinamike është dhënë në prioritet sipas afateve kohore aktuale në proceset akredituese nga ana e ZKA-se.
- DSC në përputhje me Doracakun e cilësisë ka zhvilluar pyetësorët për të gjitha aktivitetet e planifikuara të ndara në ato trajnuese dhe të arsimit të lartë. Gjithsejtë ka kryer vlerësimin e **86 trajnime** nga fushat e ndryshme duke mos numëruar këtu tri (3) trajnimet profesionale, dy (2) për Doganën e Kosovës DK, dhe një (1) për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent AME, i cili është edhe trajnimi i parë profesional që nga validimi i parë i AKSP me kualifikimin “Zjarrfikës”

Trajnimet e vlerësuara

ISP-të	PK	AKSP	DK	AME	SHKK	OSBE	Gjithsejtë
Nr. i kurseve	56	10	9	1	8	2	86
Nr. pjesëmarrësve	841	179	152	21	104	40	1337
Mesatarja e kalueshmërisë në %	86.14%	90.70%	91.90%	75.40%	92.40%	86.40%	87.16%

5.2. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË SIGURIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË (AKK, AKA, IADLEST)

Janë mbështetur njësitë organizative në zbatimin e politikave për sigurimin të cilësisë dhe procesit të përmirësimit ku janë zhvilluar 25 takime me njësite relevante duke mos përfshirë takimet e përbashkëta në kuadër të proceseve akredituese.

Bordi i AKSP-së ka themeluar grupin punues për rishikimin e standardeve të profesionit. Ky grup ka zhvilluar dy takime ku janë përfunduar 5 standarde të profesionit duke përfshirë vetëm standardin „Polic i Ri” i cili është akoma në shqyrtim.

Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së ka themeluar „ **Komisionit për sigurimin e cilësisë në AKSP**” i cili ka për qëllim të rregulloj përbërjen, funksionimin dhe procedurat administrative të funksionimit të Komisionit për sigurimin e cilësisë në AKSP. Ky komision tashmë ka zhvilluar një takim dhe ka filluar punën duke aprovuar edhe disa dokumente të sigurimit të cilësisë.

Ri-akreditimi i AKSP si IAAP me trajnime profesionale të rivaliduara

- Bazuar në vendimin nr. 2/43 të Bordi të AKSP-së, me datë 29.01.2025 u mbajt takimi i parë i grupit punues për rishikimin e standardeve të profesionit dhe krijimin e nëngrupeve profesionale për rishikimin gjere me datë 25.05.2025 kur edhe priten të aprovohen nga Bordi i AKSP para se të adresohen ne MASHT dhe AKK.
- Aplikacionet për riakreditim dhe rivalidim të programeve profesionale kanë kaluar me datë 01.07.2025 sipas njoftimit të AKK edhe përkundër tejkallimeve të afateve ligjore nga ana e AKK, ne ende mbesim peng i procesit i cili është dashtë të përmbyllet qysh në vitin 2024.
- Me datë 02.10.2025 kemi adresuar kërkesë tek AKK rreth sqarimeve mbi procesin tashmë 3 vjeçar nga data e aplikimit fillestar në vitin 2023.
- Me datë 02.12.2025 kemi zhvilluar konsultë me AKK rreth kërkesës së adresuar nga AKSP për procesin e vonuar ri-akreditues dhe ri-validues. Nga AKK jemi informuar se, AKK ende ndodhet në proces të finalizimit të Ekipeve të ekspertëve për ta përmbyllur fazën e vonuar të inspektimit.
- Me datë 12.12.2025 Bordi i AKSP aprovoj standardet e rishikuara te profesionit

- Me date 24.12.2025 janë adresuar Standardet e aprovuara nga Bordi i AKSP, për miratim në MASHT/KAAPRR.

Ri-akreditimi i AKSP si IAL dhe Ri-akreditimi i programit studimor Bachelor

- Me datë 20.05.2025 është adresuar dokumenti "procesi i akreditimit-faza e analizës-2025".
- Me datë 21.05.2025 është realizuar takimi me AKA, rreth procesit akreditues dhe sfidave në kuadër të procesit dhe rrugëtimit të arsimit të lartë në AKSP.
- Me datë 22.05.2025 është mbajtur takimi i radhës me menaxhmentin rreth procesit akreditues dhe shpalosjen e udhëzimeve të reja të dala nga takimi me AKA-në.
- Me datë 29.05.2025 është adresuar plani dinamik i veprimit-procesi akreditues nga fusha e arsimit të lartë për procesin akreditues institucional dhe programor.
- Me datë 04.08.2025 me vendim nr. 117, u themelua Grupi Punues për Hartimin e Raporteve Vetë-Vlerësuese/RVV. Grupi punues ka finalizuar RVV institucionale dhe 134 dokumentet mbështetëse, si dhe RVV programe me gjithsejtë 125 dokumente përcjellëse. Me datë 15.09.2025 AKSP-ja zyrtarisht ka dorëzuar shkresën përcjellëse, RVV-të dhe dokumente mbështetëse në AKA për ti nënshtruar proceseve vlerësuese . Takimet përgatitore është ofruar materiale përcjellëse dhe të argumentuara sipas RVV dhe shtojcave të përcjella, këshilla dhe përgatitje rreth pyetjeve dhe përgjigjeve potenciale në kuadër të proceseve të kaluara akredituese të përmbledhura ndër vite
- Me datë 25.11.2025 takim përgatitor me përfaqësuesit e ISP-ve në cilësinë e punëdhënësve,
- Me datë 26.11.2025 takim përgatitor me ALUMNI e AKSP-së,
- Me datë 27.11.2025 takimin përgatitor me studentët e FSP-së,
- Takime formale staf akademik dhe personel të AKSP
- Me datë 02.12.2025 u zhvillua edhe faza e inspektimit ne terren nga Ekipi i Eksperteve Vlerësues ndërkombëtar në cilësinë e KSCH-se se AKA.
- Me date 27.12.2025 u pranuar vlerësimi preliminar dhe rekomandimet e gjetura nga EE i KSHC se AKA.
- Me datë 29.12.2025 u shqyrtuan rekomandimet dhe të gjeturat e EE nga KSHC si të bazuara dhe e njëjta u konfirmua edhe tek koordinatori e cilësisë së AKA në procesin aktual.

5.3. AKTIVITETET DHE GJENDJA AKTUALE

DSC-ja në kuadër të aktiviteteve që kanë shënuar këtë periudhë kohore Janar-Dhjetor 2025 ka realizuar vlerësime te politikave t sigurimit të cilësisë dhe bazuar ne planin e punës ka adresuar nevojën për rishikim te disa udhëzimeve dhe procedurave të cilat në raste ekstreme mungojnë apo nuk janë rishikuar qysh nga viti 2012.

6.1. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDORE

Më 26 shkurt 2025 në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, në AKSP u mbajt Dita Informuese për Komunitetet, në të cilën morën pjesë rreth 65 pjesëmarrës nga komunitetet jo-shumicë që jetojnë në Kosovë. Ngjarja u përshëndet nga Xhelal Sveçla, Ministër i MPB-së, Maria de Benito Rodriguez, u.d. e Drejtorit të Departamentit për Rend dhe Siguri Publike në Misionin e OSBE-së në Kosovë, Elizabeth Katherine Gowing, Këshilltare e Kryeministrit për Çështjet e Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit, si dhe Kastriot Jashari, Zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm të AKSP-së si nikoqir. Ndërkaq i pranishëm në hapje ishte edhe Elbert Krasniqi, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal.

Në kuadër të përkrahjes së vazhdueshme të institucioneve të sigurisë publike të Kosovës, AKSP ishte nikoqir i punëtorisë së projektit GROWTH të financuar nga programi Erasmus+ i BE-së që u mbajt më 23 prill 2025, një ndër partnerët e të cilit është edhe Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (EMA). Kurse më 9 dhe 10 qershor 2025, në kuadër të këtij projekti, në Berane të Malit të Zi në cilësinë e ligjëruesve qëndruan dy zyrtarë të lartë të AKSP-së.

Përderisa AKSP ishte edhe njëri nga institucionet pjesëmarrëse në Panairin e Edukimit, Karrierës dhe Punës, i cili u mbajt më 15 dhe 16 prill 2025 në Prishtinë.

Më 13 nëntor 2025 përfaqësuesi nga AKSP mori pjesë në takimin e 7-të të Nënkomitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri, të ftuar nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB).

6.2. BASHKËPUNIMI ME PARTNER NDËRKOMBËTAR BRENDIA VENDIT

Misioni i OSBE-së në Kosovë.- Më 11 shkurt 2025 u mbajt takim me Njësitin Këshillues të AKSP-së nga Misioni i OSBE-së në Kosovë në lidhje me organizimin e një aktiviteti në AKSP për fëmijët e shkollave të mesme me fokus vizibilitetin dhe promovimin e ISP-ve, me pjesëmarrje nga AKSP, OSBE, PK, SHKK dhe AME.

Kurse më 13 shkurt 2025 në AKSP u mbajt një takim ndërmjet AKSP-së dhe OSBE-së, i udhëhequr nga ana e OSBE-së nga Maria de Benito Rodriguez, u.d. e Drejtorit të Departamentit për Rend dhe Siguri Publike në Misionin e OSBE-së në Kosovë dhe nga ana e AKSP-së nga Kastriot Jashari, Zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm të AKSP-së.

KFOR.- Më 5 shkurt 2025 u realizua një takim me KFOR-in Hungarez, të cilët u njoftuan me zhvillimet dhe të arriturat e fundit të Akademisë.

Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.- Më 6 shkurt 2025 u mbajt takim me ekspertin e misionit monitorues ROM nga Komisioni i BE-së për implementimin e Programit për Punë të Brendshme të Bashkimit Evropian në Kosovë (HAPE) për pjesët që i takojnë AKSP-së.

Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë.- Në kuadër të programit kundër pastrimit të parave(AML)me këtë përfaqësi diplomatike janë zhvilluar aktivitetet si vijon:

Më 22 janar 2025 në Prishtinë është mbajtur Punëtorja mbi zhvillimin e kurrikulës në Kosovë kundër pastrimit të parave, në të cilën morën pjesë 3 pjesëmarrës nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, 2 nga AKSP, 1 nga Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF), 2 nga Policia e Kosovës (PK), 1 nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe 1 nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI).

Më 23 janar 2025 në një vizitë në AKSP nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Mal të Zi të aranzhuar përmes Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë u ra dakord që në kuadër të programit kundër pastrimit të parave (AML), në të ardhmen e afërt të bashkëpunohet edhe me institucionet relevante nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut (përveç atyre nga Kosova dhe Mali i Zi).

Më 12 shkurt 2025 u prit në takim Alan Barr, ekspert kundër pastrimit të parave nga Ambasada së Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, me të cilin u diskutua për dizajnimin e një trajnimi për AKSP-në për nevojat e NJIF, PK, ATK dhe agjencive të tjera të zbatimit të ligjit në luftimin e terrorizmit dhe kundër pastrimit të parasë.

Kurse më 17 mars 2025 u mbajt takim i përbashkët ndërmjet AKSP-së, Akademisë së Drejtësisë (AD) dhe Projektit kundër pastrimit të parave (AML) të Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë në hapësirat e AD në Prishtinë, në të cilin u diskutua për trajnimet dhe aktivitetet e Projektit AML që do të zhvillohen për AKSP dhe NJIF me interes të gjithë zbatuesve të ligjit në Kosovë e ku AD ftohet për tu përfshirë.

Më 12 dhjetor 2025 në AKSP u mbajt sesioni informues për programin Erasmus+ për stafin dhe studentët e AKSP-së nga Zyra e Erasmus+ në Kosovë, ku të pranishmit u njoftuan gjerësisht në lidhje me të rejat në Udhëzuesin e Erasmus+ për vitin e ardhshëm 2026, përfshirë dhe afatet e fundit për aplikim për aktivitetet përkatëse.

6.3. BASHKËPUNIMI ME ASOCIACIONE DHE RRJETE NDËRKOMBËTARE

Agjencia e Bashkimit Evropian për Trajnim në Zbatimin e Ligjit (CEPOL): Gjatë tremujorit të parë të vitit 2025 është përfunduar me sukses aplikimi në Programin e Shkëmbimit të CEPOL 2025 për 9 zyrtarë nga institucionet e zbatimit të ligjit nga Kosova, miratimi për të cilët do të merret nga CEPOL dhe të cilët do të shkëmbehen gjatë këtij viti me homologët e tyre. Për të ardhur deri te këto aplikime, zyrtarët e DMJ të AKSP-së, përndryshe pjesë e

ekipit të Njesisë Kombëtare të CEPOL (CNU) për Kosovën, gjatë shkurtit 2025 zhvilluan konsultime dhe komunikim me pikat e kontaktit dhe të interesuarit nga institucionet e zbatimit të ligjit për të aplikuar në këtë program. Kurse më 6 shkurt 2025 u mbajt një takim me pikat e kontaktit nga NJIF dhe DK për t'i njoftuar me procedurat e aplikimit dhe realizimit të tij.

Pjesëmarrja në takimet e rregullta të ekipit të Njesisë Kombëtare të CEPOL (CNU).- Ekipi i Njesisë Kombëtare të CEPOL (CNU) për Kosovën, i përbërë nga Udhëheqësi i Divizionit për Marrëdhënie me Jashtë (DMJ) dhe Zyrtari për Marrëdhënie me Jashtë në këtë Divizion në AKSP kanë marrë pjesë në takimet e rregullta online të organizuar nga CEPOL, dhe atë: Menaxheri Kombëtar i LEEEd (NLM) të CEPOL për Kosovën ka marrë pjesë në takimin online më 23.01.2025 dhe Pika Kombëtare e Kontaktit (NCP) e CEPOL për Kosovë ka marrë pjesë në takimin online të Njësive Kombëtare të CEPOL (CNU) mbajtur më 21.03.2025.

Asociacioni Evropian i Kolegjeve të Shërbimit të Zjarr fikjes (EFSCA).- Më 20 janar 2025 Udhëheqësi i DMJ-AKSP-së mori pjesë në takimin online të Asamblesë së Përgjithshme të EFSCA-së.

6.4. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE TË NDRYSHME JASHTË VENDIT

Mali i Zi - Më 22 prill 2025 është nënshkruar Marrëveshja e bashkëpunimit e ripërtërirë ndërmjet AKSP-së dhe Akademisë Policore të Malit të Zi. Kurse më 12 dhe 13 qershor 2025 një delegacion i lartë i AKSP-së zhvilloi një vizitë pune në këtë institucion, me ç'rast nikoqirëve iu dorëzuan programet e arsimit të lartë dhe trajnimit profesional për polic.

Shqipëria.- Më 17 dhjetor 2025 AKSP u përfaqësua në Konferencën XI-të Shkencore Ndërkombëtare “Forcimi i proceseve të integritimit ndërmjet policisë shkencore, praktikës policore dhe inteligjencës artificiale” të Akademisë së Sigurisë së Shqipërisë, nga u.d. Dekani i Fakultetit të Sigurisë Publike, Prof. Asoc, i cili mori pjesë në sesionet shkencore “Keqpërdorimi i Inteligjencës Artificiale “

Kroacia.- Nga 27 – 30 tetor 2025, u.d. i Drejtorit të Përgjithshëm të AKSP-së, i shoqëruar nga Udhëheqësi i Divizionit për Marrëdhënie me Jashtë (DMJ) në AKSP morën pjesë në takimin rajonal strategjik të Udhëheqësve/Drejtuesve të akademive policore/qendrave të trajnimit dhe përfaqësuesve të policisë kufitare “Përpjekja e Përbashkët për Ndërtimin e Kapaciteteve: Mbikëqyrja e Kufirit në Respektim të të Drejtave të Njeriut”, i cili u mbajt në Zagreb, Kroaci.

Bullgari- Më 16 korrik 2025 në AKSP u zhvillua një vizitë nga një delegacion i Shërbimit Kombëtar të Mbrojtjes të Bullgarisë, udhëhequr nga Shefi i këtij Shërbimi, Gjeneralmajor

Emil Simeonov Tonev, dhe shoqëruar nga ambasadori i Bullgarisë në Kosovë, Sh. T. Z. Hristo Kraevski, i cili premtoi angazhimin e tij për nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet AKSP-së dhe Akademisë së Punëve të Brendshme të Bullgarisë.

Danimarka - Më 12 qershor 2025 AKSP pranoi në vizitë delegacionin nga shërbimi i burgjeve të Danimarkës, përmes bashkëpunimit që institucioni jonë ka me Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK). Në takim ndër të tjera u diskutua për mundësinë e nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet AKSP-së dhe institucionit përkatës të Danimarkës për ngritjen e kapaciteteve në fushën korrektuese.

Gjermania.- Nga 27 - 30 tetor 2025 dy zyrtarë të lartë të AKSP-së, përkatësisht Udhëheqësi i Divizionit për Kurrikula dhe Testime (DKT) dhe Udhëheqësi i Divizionit për Teknologji Informative (DTI), morën pjesë në punëtorinë profesionale të organizuar nga Policia Federale Gjermane për modernizimin e trajnimeve në fushën e sigurisë publike në kuadër të projektit evropian “EU-ISF SCOPE III – Virtual Classroom”, e cila u mbajt në Qendrën Federale të Trajnimit dhe Arsimit të Policisë në Eschwege, Gjermani.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës - Nga 19 - 24.05.2025 një delegacion i AKSP-së, në përbërje të cilit ishin edhe zyrtarë nga Institucionet e Sigurisë Publike (Dogana e Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës dhe Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave) zhvilluan një vizitë studimore në Akademinë e Drejtësisë së Karolinës së Veriut (NCJA) SHBA. Vizita është përkrahur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe paraqet vizitën e dytë studimore të AKSP-së me të gjitha 6 (gjashtë) ISP-të që kanë për qëllim funksionalizimin e plotë të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë së AKSP-së, duke ngritur kështu edhe nivelin e bashkëpunimit me NCJA pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet të dyja institucioneve.

Aktivitete dhe bashkëpunime tjera : Më 1 korrik 2025 AKSP u vizitua nga profesori David Walsh nga Universiteti profesor i hetimeve penale në Shkollën e Drejtësisë të Universitetit De Montfort, Leicester, Mbretëri e Bashkuar, njëherësh Kryesues i Veprimit CA22128 - Krijimi i Rrjeteve për Zbatimin e Parimeve mbi Intervistimin Efektiv për Hetime (ImpleMéndez) të Bashkëpunimit Evropian në Shkencë dhe Teknologji (COST). Ai inkurajoi të pranishmit që të jenë pjesë aktive e këtij projekti.

Më 16 dhjetor 2025 AKSP pranoi një vizitë nga Katrine Antonsen, kandidate për doktoraturë nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Oslos, Norvegji në lidhje me grumbullimin e informatave për temën e saj të doktoraturës.

6.5. VIZITAT ZYRTARE DHE NGJARJET ONLINE TË REALIZUARA

Të paraqitura në mënyrë tabelare, vizitat e realizuara në AKSP gjatë vitit 2025 janë si në vijim:

Data	Vizitat në AKSP të institucioneve/organizatave
23.01.2025	Vizitë nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Mal të Zi dhe Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë në kuadër të programit kundër pastrimit të parave (AML)
06.02.2025	Vizitë nga pikat e kontaktit të Njesisë së Inteligjencës Financiare (NJIF) dhe Doganës së Kosovës (DK) për Programin e Shkëmbimit të CEPOL
12.02.2025	Vizitë dhe takim pune nga Alan Barr, ekspert kundër pastrimit të parave nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë
13.03.2025	Vizitë nga Misioni i OSBE-së në Kosovë
10.04.2025	Vizitë nga Komuna Växjö e Suedisë dhe Komuna e Vushtrrisë
14.04.2025	Vizitë nga Misioni i OSBE-së në Kosovë
17.04.2025	Vizitë nga Ambasadori i Republikës së Turqisë në Kosovë
22.04.2025	Vizitë nga Akademia Policore e Malit të Zi, kur dhe u nënshkrua Marrëveshja e bashkëpunimit e ripërtërirë ndërmjet të dyja institucioneve
23.04.2025	Vizitë nga Projekti GROWTH i financuar nga Erasmus+ dhe zyrtarë nga AME
13.05.2025	Vizitë nga Komuna Växjö e Suedisë dhe Komuna e Vushtrrisë
12.06.2025	Vizitë nga zyrtarët e sistemit korrektues nga Danimarka
16.06.2025	Vizitë nga stafi menaxhues i Programit për Punë të Brendshme të Bashkimit Evropian në Kosovë (HAPE)
01.07.2025	Vizitë nga profesori David Walsh nga Universiteti De Montfort, Leicester, Mbretëri e Bashkuar, njëherësh Kryesues i Veprimit CA22128 - Krijimi i Rrjeteve për Zbatimin e Parimeve mbi Intervistimin Efektiv për Hetime (ImpleMéndez) të Bashkëpunimit Evropian në Shkencë dhe Teknologji (COST)
02.07.2025	Vizitë nga Akademia Diplomatike e MPJD
16.07.2025	Vizitë nga Shërbimi Kombëtar i Mbrojtjes i Bullgarisë
19.08.2025	Vizitë nga Drejtori i i Departmantit për Rend dhe Siguri Publike (DRSP) pranë Misionit të OSBE-së në Kosovë, Bertram Welsing, me bashkëpunëtorë
02.10.2025	Vizitë nga Zbatimi i Ligjit të Iowa-s
16.10.2025	Vizitë dhe prezentim në AKSP në kuadër të procesit të rishikimit të sistemit të Menaxhimit Emergjent/Mbrojtjes Civile në Republikën e Kosovës nga ekspertët e përzgjedhur nga Mekanizmi Evropian i Mbrojtjes Civile Evropiane (DG ECHO), me mbështetje nga CMCC Italiane, të cilët qëndruan në Kosovë nga 12 - 18 tetor 2025
03-04.12.2025	Punëtorja Rajonale e IPK-së “Transparenca e Agjencive Mbikëqyrëse Policore dhe Roli i Transparencës në Forcimin e Integritetit Policor”
04.12.2025	Vizitë nga KFOR-i Hungarez
09.12.2025	Vizitë nga Ekipi Këshillues dhe Ndërlidhës i NATO-s (NALT)

12.12.2025	Sesioni informues për programin Erasmus+ për stafin dhe studentët e AKSP-së nga Zyra e Erasmus+ në Kosovë
16.12.2025	Vizitë nga Katrine Antonsen nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Oslos, Norvegji për temën e saj PhD
18.12.2025	Vizitë nga KFOR-i Hungarez

Kurse në vijim janë të pasqyruara ngjarjet online të karakterit të bashkëpunimit me jashtë, në të cilat kanë marrë pjesë punonjës të AKSP-së:

Data	Ngjarjet e mbajtura online me pjesëmarrës nga AKSP
20.01.2025	Pjesëmarrja në takim online të Asamblesë së Përgjithshme të Asociacionit Evropian të Kolegjeve të Shërbimit të Zjarr fikjes (EFSCA)
23.01.2025	Pjesëmarrja në takim online të Menaxherëve Kombëtarë të LEEd (NLM) të CEPOL
10.03.2025	Pjesëmarrja në takim online me Zyrën e BE-së në Kosovë
21.03.2025	Pjesëmarrja në takim online të Njësive Kombëtare të CEPOL (CNU)

Po ashtu gjatë kësaj periudhe kohore janë zhvilluar edhe vizitat nga stafi i AKSP-së si vijon:

Data	Vizitat e AKSP në institucione/organizata të ndryshme
22.01.2025	Pjesëmarrja në Punëtorinë mbi zhvillimin e kurrikulës në Kosovë kundër pastrimit të parave, organizuar nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë
06.02.2025	Pjesëmarrja në takim me ekspertin e jashtëm monitorues të projektit 'Home Affairs Program of European Union in Kosovo Project (HAPE)' ku përveq MPB-së, PK-së, edhe AKSP nga fushëveprimataria e saj është e përfshirë në këtë projekt
17.03.2025	Pjesëmarrja në takim e përbashkët ndërmjet AKSP-së, Akademisë së Drejtësisë (AD) dhe Projektit kundër pastrimit të parave (AML) të Ambasadës së Britanisë së Madhe në Kosovë në AD, Prishtinë
01 - 02.04.2025	Pjesëmarrja në takim e 17-të të Menaxherëve Kombëtarë të LEEd (NLM) të CEPOL në selinë qendrore të CEPOL në Budapest, Hungari
03 - 04.04.2025	Pjesëmarrja në takim e 17-të të Njësive Kombëtare të CEPOL (CNU) në selinë qendrore të CEPOL në Budapest, Hungari
15 - 16.04.2025	Pjesëmarrja në Panairin e Edukimit, Karrierës dhe Punës në Prishtinë
19 - 24.05.2025	Vizitë në Akademinë e Drejtësisë së Karolinës së Veriut (NCJA) me përfaqësues edhe nga ISP- të (DK, SHSK dhe AME) me përkrahjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë
27 - 28.05.2025	Pjesëmarrja në Asamblenë e Përgjithshme dhe Konferencën Vjetore 2025 të EFSCA-së "EFSCA në zemër të Evropës" ("EFSCA in the Heart of Europe"), Bruksel, Belgjikë
28.05.2025	Vizitë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) ku u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet AKSP dhe KGJK
01 - 04.06.2025	Pjesëmarrja në Konferencën vjetore të IADLEST, Charlotte, Karolina e Veriut, SHBA

28.05.2025	Vizitë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet AKSP-së dhe KGJK-së
09-10.06.2025	Pjesëmarrja në cilësinë e ligjëruesve të 2 zyrtarëve nga AKSP në kuadër të projektit GROWTH të Erasmus+ në Berane, Mali i Zi
12-13.06.2025	Vizitë në Akademinë Policore të Malit të Zi
03.07.2025	Pjesëmarrja në takimin e Komitetit Drejtues të Programit për Punë të Brendshme të Bashkimit Evropian në Kosovë (HAPE)
07 - 09.10.2025	Pjesëmarrja në Kongresin e 8-të Ndërkombëtar të FRANCOPOL, Paris, Francë
13 - 15.10.2025	Pjesëmarrja në takimin e themelimit të Asociacionit Rajonal të Akademive Policore/Qendrave të Trajnimeve të Evropës Juglindore (RAPATC SEE) në Shkup, Maqedoni e Veriut
14 - 16.10.2025	Pjesëmarrja në punëtorinë profesionale të organizuar nga Policia Federale Gjermane për modernizimin e trajnimeve në fushën e sigurisë publike në kuadër të projektit evropian "EU-ISF SCOPE III - Virtual Classroom" në Qendrën Federale të Trajnimit dhe Arsimit të Policisë në Eschwege, Gjermani
27 - 30.10.2025	Pjesëmarrja në takimin rajonal strategjik të Udhëheqësve/Drejtuesve të akademive policore/qendrave të trajnimit dhe përfaqësuesve të policisë kufitare "Përpjekja e Përbashkët për Ndërtimin e Kapaciteteve: Mbikëqyrja e Kufirit në Respektim të të Drejtave të Njeriut" në Zagreb, Kroaci
06 - 08.11.2025	Pjesëmarrja në takimin e 14-të të Asociacionit Ndërkombëtar të Akademive Policore (INTERPA) në Nevşehir, Cappadocia, Turqi
09.12.2025	Vizitë në Programin e INL në Kosovë, Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë, për vlerësimin e sektorit të zbatimit të ligjit dhe drejtësisë me fokus në krimin e organizuar transnacional


7. KOMUNIKIMI DHE MEDIA



Me qëllim të promovimit të vlerave, ngritjes së imazhit dhe transparencës Institucionale gjatë kësaj periudhe të gjitha zhvillimet dhe aktivitetet që mbahen në Akademi bëhen transparente në forma të ndryshme duke i publikuar në portale, rrjete sociale e po ashtu edhe në radio dhe televizione.

Në lidhje me këtë, gjatë kësaj periudhe raportuese në ueb-faqen e AKSP-së, portale elektronike informative, televizione, radio, gazeta, revistat vendore janë publikuar **40 informata**, lajme, ngjarje dhe aktivitete ndërsa pas ridizajnimit të ueb-faqes së re të AKSP, dokumentet janë duke u përditësuar në vazhdimësi deri tani janë të publikuar **128 dokumente** si pjesë e angazhimit për transparencë dhe përmbushjen e nevojave institucionale.

Po ashtu zyra e Mediave përcjell aktivitetet e të gjitha Institucioneve të cilat ndërlidhen me AKSP-në. Zyra e Mediave ka mbajtur aktive ueb-faqen e AKSP-së, faqen e Fakultetit të Sigurisë si dhe rrjetin sociale, siç është FACEBOOK, duke plasuar të gjitha informatat nga aktivitetet që janë mbajtur në AKSP si dhe ka pasuruar atë me dokumente konformë kërkesave dhe projekteve të Akademisë.



8. AUDITIMI



Auditimi i Jashtëm -


Gjatë muajit qershor është publikuar raporti i auditimit të jashtëm ZKA për MPB - AKSP ku ne si Institucion nuk *kemi pranuar asnjë rekomandim sipas procesit të auditimit për vitin 2024.*

Auditimi i brendshëm -

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin në fuqi dhe me qëllim të realizimit të objektivave të auditimit që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe me përmirësimin e efikasitetit në punë.

Sipas planifikimit të auditimit për vitin 2025, gjatë periudhës raportuese nga ana e Divizionit të Auditimit të Brendshëm/DAB janë zhvilluar 4 procese audituese të njëjësive si vijon:

- ✓ Procesi auditues tek Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përbashkëta/ **DFSHP** ku edhe është finalizuar dhe adresuar raporti me rekomandimet konkrete.
- ✓ Procesi auditues tek Departamenti i Trajnimeve dhe Përkrahjes Arsimore / **DTPA** ku edhe është finalizuar dhe adresuar raporti me rekomandimet konkrete
- ✓ Procesi auditues tek Divizioni i Prokurimit/ **DP** i cili është finalizuar dhe adresuar raporti me rekomandimet konkrete
- ✓ Procesi auditues tek Divizionin e Buxhetit dhe Financave/ **DBF** cili është finalizuar dhe adresuar raporti me rekomandimet konkrete



Duke u bazuar në Planin e Divizionit të Prokurimit për vitin 2025, AKSP ka planifikuar 37 aktivitete të prokurimit sipas planit të dorëzuar në ZKA- AKSP dhe AQP për realizim ashtu siç obligohet me aktet ligjore për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Gjatë periudhës raportuese janar – dhjetor 2025 Divizioni i Prokurimit, ka arrit të realizoj përfundoj 30 kontrata nga aktivitetet e prokurimit, ndërsa janë publikuar dhe janë në proces të vlerësimit 2 aktivitete të prokurimit dhe 1 Ankesë në OSHP.

Planifikimi i Prokurimit AKSP 2025

